

# AKTI I THEMELIMI

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

M-Fashion shpk



### Neni 1

Shoqëria e emërtuar M-Fashion shpk, është krijuar nga ortakut i vetëm themelues :

Marsida Ilirjan Pohumi , shtetase Shqiptare, banuese ne Shqiperi , banuese ne Lagja Koder Shijak , e datelindjes 25.06.1988 , lindur ne Kryevideh Durres ,certifikata 077 009793 .

### Neni 2

Selia e shoqërisë do jetë në Lagja 14 Rruga Tirana Durres. Me vendim të Ortakut të vetëm mund të hapen filiale apo forma të tjera shoqërish, brënda e jashtë vendit.

### Neni 3

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë mbi 10 vjet dhe do të fillojë nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me përjashtim të rasteve kur mbaron sipas parashikimeve me ligj ose kur vendos Asambleja Ortakeve.

### Neni 4

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: Import Eksport;; Prodhimin dhe tregëtimin me shumice dhe pakice, me anën e import eksportit, të veshjeve e konfeksioneve të gjithëllojeshme, të stilit dhe modeleve klasik, sportive dhe intime, me të gjitha llojet e metrazheve, për burra, gra dhe fëmijë, si me material të vetin dhe të porositësit: Prodhim të artikujve të çfardo lloji prej lëkure, sikurse janë artikujt e galanterisë (Borseterie) si çanta, portofole, rripa mesi etj. , kepuce, xhakavento e të çdo lloji artikulli tjetër prej lëkure, për veshje e përdorime të tjera, si dhe tregëtimin e tyre me shumice dhe pakice, brenda dhe jashtë vendit;; Organizimin dhe pjesëmarrjen e sfilatave të modes, brenda dhe jashtë vendit, pjesëmarrje në panairë kombëtare e ndërkombëtare, me prodhimet e veta etj.; Çeljen dhe funksionimin e rregullt të kurseve të kualifikimit profesional në tushen e njohjes dhe përdorimit të teknologjisë së produkteve të prodhuara si dhe për kontrollin e cilësive së tyre sipas standartit dhe markes së prodhimit;

### Neni 5

Kapitali themeltar është 100.000 lekë i formuar si me poshte:

Marsida Pohumi 100.000 leke me 100% të kapitalit

### Neni 6

Për nevoja të punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj.

### Neni 7

Administratori i shoqërisë do të jetë Marsida Pohumi.

### Neni 8

Për nevoja të punës kjo shoqëri mund të punësojë edhe punëtorë e specialistë të ndryshëm me kontrate të rregullt pune, sipas ligjeve në fuqi.

### Neni 9

Shoqëria do të rregullohet përveç këtij akti edhe me norma të përcaktuara në statut.

Akti i themelimit u perpilua ne 4 kopje per tu administruar sipas ligjit.

### Ortaku i Vetem

(Marsida Pohumi)

*Marsida Pohumi*

*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Dhoma Notereve Tirë

Nr 4385 Rep. —

### VERTETIM

Sot me datë 24/5/ 2007, para meje noterit M. Sela u paraqit personalisht Marsida Pohumi shtetase Shqiptare, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identiteti e të ciles u sigurova nga Certifikata e lindjes nr serial 077 009793 e leshuar ne Shijak me date 21.05.2007 e cila deklaroj se, për sa më sipër është shkruar sipas vullnetit të saj të lirë dhe të plotë dhe nënshkruan para meje. Unë noteri e vërtetoj sipas ligjit.

Noteri

(  
NOT F  
ARGEN  
LA  
24

*Taksa e paguar*  
*[Stamp]*  
*[Signature]*

# STATUTI

## SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KURIZUAR



### **M-Fashion**

#### **Neni 1**

Shoqëria e emërtuar **M-Fashion sh.p.k.** është krijuar nga ortakut i vetëm themelues :  
Marsida Ilirjan Pohumi , shtetase Shqiptare, banuese ne Shqiperi , banuese ne  
Lagjen Kodra Shijak ,e datelindjes 25.06.1988 , lindur ne Kryevideh Durres ,certifikata 077 009793.

#### **Neni 2**

Shoqëria është formuar sipas legjislacionit shqiptar dhe si person juridik fillon me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar të gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

#### **Neni 3**

Shoqëria e ka selinë në Lagja 14 Rruga Tirana Durres.Ajo mund të ndryshojë selinë e saj me vendim të Asamblese Ortakeve.

#### **Neni 4**

Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me statutin e saj në teritorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij.

#### **Neni 5**

Fusha e autoritetit te ortakut dhe perqindja e fitimeve ose e humbjeve, kopetencat që gëzon në marrjen e vendimeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e shoqërisë.

#### **Neni 6**

Për të saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të ketë librin e vet i cili do të quhet libri i shoqërisë.

#### **Neni 7**

Ortakët dhe personat e tjerë të pranuar në shoqëri bien dakort që të mos i ekspozojnë asnjë personi të jashtëm informacionet që disponon shoqëria, kontratat që do të lidhë si dhe planet ose qëllimet që ka për të ardhmen.

#### **Neni 8**

Të gjitha aktet dhe dokumentat që nxirren nga shoqëria dhe të destinuara për të tretët, si shkresat, fatuart, lajmërimet, publikimet etj. duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë.

#### **Neni 9**

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj: Import Eksport; Prodhimin dhe tregëtimin me shumice dhe pakice, me anën e import eksportit, te veshjeve e konfeksioneve te gjithellojeshme, te stilit dhe modeleve klasik, sportive dhe intime, me te gjitha llojet e metrazheve, per burra, gra dhe femije, si me material te vetin dhe te porositesit: Prodhim te artikujve te cfardo lloji prej lekure, sikurse jane artikujt e galanterise (Borseterie) si çanta, portofole, rripa mesi etj. , kepuce, xhakavento e te çdo lloj artikulli tjeter prej lekure, per veshje e perdorime te tjera, si dhe tregëtimin e tyre me shumice dhe pakice, brenda dhe jashte vendit; Organizimin dhe pjesemarrjen e sfilatave te modes, brenda dhe jashte vendit, pjesemarrje ne panire kombetare e nderkombetare, me prodhimet e veta etj; Çeljen

dhe funksionimin e rregullt te kurseve te kualifikimit profesional ne fushen e njohjes dhe perdorimit te teknologjiise se produkteve te prodhuara si dhe per kontrollin e cilesise se tyre sipas standartit dhe markes se prodhimit .

#### **Neni 10**

Shoqëria do të zhvilloj aktivitetin e saj mbi 10 vjet, duke filluar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar te gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë, me përjashtim të rastit të mbarimit të afatit sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të Asamblese Ortakeve.

#### **Neni 11**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000,00 lekë: Shoqëria mund të shtojë kapitalin e saj sipas vendimit të Asamblese Ortakeve dhe miratimit ne gjykate.

#### **Neni 12**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 i zoteruar nga ortaku i vetem :  
Marsida Pohumi 100.000 leke me 100% te kapitalit

#### **Neni 13**

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme tek personat e tretë në qoftë se vendos për këtë Asambleja Ortakeve. Gjithashtu ato janë lirisht të transferueshme në rast ndarje pasurore mes bashkëshortëve si dhe në rrugë trashëgimie. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial.

#### **Neni 14**

Shoqëria do ta konsideroj qendrën e vet si shoqëria mëmë e cila rast pas rasti mund të hapet me anë filialesh, agjensish në të gjitha ato vende ku do të shikoj interes në përmbushjen e qëllimit të saj në të gjithë teritorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë tij.

#### **Neni 15**

Organet e shoqërisë janë :1.Asambleja Ortakeve dhe 2.Administratori

#### **Neni 16**

Administrator i shoqërisë ngarkohet Marsida Pohumi e cila eshte përgjegjëse për shkelje ligjore, për shkelje të statutit ose për gabime e faje të kryera gjatë administrimit.

#### **Neni 17**

Shoqëria është e detyruar të mbajë dokumentacionin kontabël, Librin e shoqërisë në të cilin shënohen emri i plotë i shoqërisë, Ortaket, kapitali themeltar si dhe vendimet që merr Asambleja Ortakeve.

#### **Neni 18**

Bilanci financiar mbyllet më 31 dhjetor të çdo viti. Llogaritë vjetore, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël miratohen nga Asambleja Ortakeve. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brënda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar. Shpërndarja e shoqërisë mund të vijë për çdo arsye. Për këtë Asambleja Ortakeve vendos për mënyrën e likuidimit të saj. Caktohen një ose disa likuiditorë. Këta bëjnë kujdes që shoqëria të likujdojë me parë detyrimet që ajo u ka personave fizik e juridik.

#### **Neni 19**

Asambleja Ortakeve nëpërmjet vendimeve që merr realizon të gjithë veprimtarinë e shoqërisë. Ajo përcakton drejtimit kryesore, vendos për bilancin vjetor, për ndryshimet në statut,



në aktin e themelimit, për shtimin e kapitalit, për pranimin në shoqëri të ortakëve të tjerë, të gjitha këto në zbatim të ligjit për shoqëritë tregtare.

Shoqëria përgjigjet vetëm me pasurinë e saj. Ajo nuk përgjigjet për detyrimet që Ortaket e saj marrin përsipër si persona fizike tej veprimtarisë së shoqërisë dhe nuk detyrohet pa vullnetin e tyre të përballojnë personalisht humbjet e shoqërisë tej kontributit në kapital.

### Neni 20

Administratori lidh kontrata me persona fizik e juridik shtetëror ose privat, vendas e të huaj sipas vendimeve që merr ortaku i vetëm, si dhe ndjek drejtimit e aktivitetit të shoqërisë. Administratori ka të drejtë të emërojë përfaqësues të posaçëm çdo person të tretë për të kryer veprime në emër të tij për llogari të shoqërisë. Asambleja Ortakeve vendos për fuqinë punëtore, për pagat e tyre duke lidhur kontrata me ta sipas marrëveshjes së dyanshme, në përputhje me ligjet shqiptare.

### Neni 21

Shoqëria ka vulën e saj me përmbajtje Firma M-Fashion shpk, Durrës – Albania

### Neni 22

Përsa nuk është shkruar në këtë statut i referohet plotësimeve nga vendimet e Asamblese Ortakeve si dhe ligjeve përkatëse shqiptare për shoqëritë tregtare.

### Neni 23

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit do ti paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente.

### Neni 24

Ky statut është hartuar në 4 kopje për tu administruar sipas ligjit.

Ortaku i Vetëm  
(Marsida Pohumi)  
*Marsida Pohumi*  
*[Signature]*

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Dhoma Notereve *Tim*

Nr. *488* Rep. *---*

### VERTETIM

Sot me datë *24.6.2007*, para meje noterit *M. Sela* u paraqit personalisht Marsida Pohumi shtetase Shqiptare, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identiteti e të ciles u sigurova nga Certifikata e lindjes nr serial 077 009793 e leshuar në Shijak me date 21.05.2007 e cila deklaroj se, për sa më sipër është shkruar sipas vullnetit të saj të lirë dhe të plotë dhe nënshkruan para meje. Unë noteri e vërtetoj sipas ligjit.



Noteri  
(MARGENA CELA)  
CEL: 069 21 21 624